



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 308/Prot.
3

Koplik, më 7.03.2022

V E N D I M

Nr. 1 Datë 28 / 02 / 2022

**“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NE 6% TË FONDIT TË
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 28.02.2022, duke u mbështetur në VKM 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteriave, dokumentacionit dhe masës së Ndihmës Ekonomike”, si dhe Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” Sektori i Sherbimeve Sociale:

V E N D O S I:

1. Të miratohen kriteret specifike mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak për të trajtuar me Ndihmë Ekonomike duke përdorur deri ne 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”familjet të cilat nuk shpallen fituese sipas formulës së pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e poshtëshënuara:
 - a. Familjet që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, konstatuar me vizitë familje nga grupi i punës.
 - b. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me probleme shëndetësore dhe si të tillë janë të paafte për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk trajtohen me pagesë paaftesie.
 - c. Familjet me kryfamiljare gra (nëna-vajza, të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - d. Personat që nuk kanë në pronësi një banesë, apo jetojnë me qira.
 - e. Individët me statusin e jetimit (të fituar) që nga momenti i daljes nga institucionet e përkujdesjes.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për

Veteqeverisjen Vendore“;

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emitjan Hasmuajaj

Miratuar me 28.02.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.03.2022

